



THIRRJE PËR APLIKIM

FORUMI RINOR NDËRKOMBËTAR PËR PUNËSIM TË GJELBËRT

« TRANZICIONI ENERGJETIK NË BALLKAN : TRENDET E TEKNOLOGJIVE TË REJA DHE MUNDËSITË PËR ENERGJI TË RIPËRTRISHME »

EDICIONI I DYTË RAJONAL PËR EVROPË QËNDRORE DHE LINDORE

Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (OIF) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, organizojnë **më 3-5 tetor 2019 në Gjakovë, edicionin e dytë rajonal për Evropë Qëndrore dhe Lindore të Forumit Ndërkombëtar për Punësim të Gjelbërt (FRPGj)**, nën patronazhin e lartë të Shkëlqësisë së Tij, z. Hashim THAÇI, President i Republikës së Kosovës. Së bashku, lëshojnë këtë thirrje për aplikim për përzgjedhjen e të rinjve që do të marrin pjesë në forum. Gjithsej, 100 të rinj do përzgjidhen për pjesëmarrje.

Qëllimi i forumit është promovimi i punësimit të gjelbër në favor të të rinjve

L'objectif du forum est de promouvoir les emplois verts au profit des jeunes.

FRPGj është një forum që u mundëson të rinjve frankofon, nga mosha 18 deri 34 vjeç, të vëjnë në zbatim kreativitetin e tyre, duke pasur mundësi të prezantojnë para një publiku të gjerë dhe partnerëve potencial financiarë dhe teknikë, projekte të dedikuara për krijimin e vendeve të punës në fushën e ekonomisë së gjelbërt. Përgjatë forumit, të rinjtë bartës të projekteve do takojnë të rinjë të tjerë me të cilët do të kenë mundësi të shkëmbejnë përvoja, idetë dhe praktikat e mira, si dhe të përfitojnë, falë punëtorive trajnuese, njohuri dhe kompetenca të reja për realizimin e projekteve të tyre.

Gjatë FRPGj, do organizohet konkursi « Projektet më të mira të ndërmarrësisë së gjelbërt » për të identifikuar dhe shpërblyer projektet më të mira në fushat e përmendura këtu më poshtë. Fituesit do të marrin trajnim intenziv për konsolidimin e projekteve të tyre; si dhe do përfitojnë nga një kuadër i veçantë mentorimi dhe një shumë financiare, e cila do të përcaktohet më vonë.

Fushat përkatëse

Për edicionin e FRPGj që do mbahet në Gjakovë, Kosovë, nga 3 deri 5 tetor 2019, të rinjtë ftohen të paraqesin projektet e tyre për krijimin e ndërmarrjeve, krijimin e vendeve të punës apo realizimin e projekteve në fushat në vijim :

- Agrikulturë dhe peshkim
- TIC për zhvillim
- Trajtimi i ujërave dhe mbeturinave
- Riciklimi dhe pastrimi
- Energjitë e ripërtrishme dhe efikasiteti energjetik
- Industritë minerare dhe degëzimet e tyre
- Turizëm, hoteleri, argëtim
- Transport dhe logjistikë
- Ndërtimtari dhe punë publike
- Shërbime (trajnime, normalizime, etiketime)

Kriteret për aplikim dhe kriteret e përzgjedhjes

- Të keni nga 18 deri në 34 vjet.
- Të jeni shtetas i një shteti anëtar apo vëzhgues në ONF të Evropës Qëndrore apo Lindore në vijim : Armenia, Bosnia-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Greqia, Hungaria, Kosova, Letonia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i zi, Polonia, Rumania, Shqipëria, Serbia, Sllovenia, Sllovakia, Qipro, Republika Çeke dhe Ukraina.
- Të keni një projekt për krijimin e punëve në sektorin e gjelbërt gati për prezantim.
- Të keni qenë i angazhuar në komunitetin tuaj.
- Pjesëmarrësit do zgjidhën në bazë të përkatësisë, mundësisë së realizimit të projektit sipas kontekstit të vendit të tyre, kapacitetit të krijimit të vendeve të punës në sektorin e gjelbërt dhe të cilësisë së hartimit të projektit të tyre.
- Preferimisht të keni një nivel minimum bazë të gjuhës frengë,
- Projektet duhet të dorëzohen në gjuhë frengë (hartuar direkt nga aplikantët apo të përkthyer më pas)

Kandidatëve të përzgjedhur do u mbulohen **të gjitha shpenzimet** (transporti, sigurimi, fjetja dhe ushqimi) për pjesëmarrje në Forumin Ndërkombëtar Frankofon « Rinia dhe Punësimi i Gjelbërt » në Gjakovë (Kosovë).

Afati i fundit për të dorëzuar aplikacionin është 20 korrik 2019 në mesnatë (koha universale).

Aplikimi për të gjithë pjesëmarrësit bëhet duke plotësuar formularin online. Gjithashtu, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës do postojnë thirrjen për aplikim në faqet e tyre të internetit dhe në media sociale.

Për informata shtesë kontaktoni :

Organizata Ndërkombëtare e Frankonisë

- Mme Rennie YOTOVA, Drejtoreshë, Zyra rajonale për vendet e Evropës qëndrore dhe lindore (Bureau régional pour les pays de l'Europe centrale et orientale -BRECO)
- Tél: +(40) 21 314 9764 email : rennie.yotova@francophonie.org
- Mme Catalina SPINU, Këshilltare, Zyra rajonale për vendet e Evropës qëndrore dhe lindore (Bureau régional pour les pays de l'Europe centrale et orientale -BRECO),
- Tél: + (40) 21 314 97 98 email : catalina.spinu@francophonie.org
- M. Youssef ARRIF, Zv. drejtor për arsim dhe rini,
- Tél: +33 1 4437 1260 email: youssef.arrif@francophonie.org

Ministria e punëve të jashtme të Republikës së Kosovës

- znj. Bardha ETEMI, Zyrtare e Lartë për organizata ndërkombëtare - korrespondente kombëtare pranë OIF, Tel: +383(0)38-200-77128 | +383(0)45-406-878 Courriel : bardha.etemi@rks-gov.net

Për të parë postimin origjinal, ju lutem klikoni:

<https://jeunesse.francophonie.org/item/1003-appel-a-candidatures-forum-international-jeunesse-et-emplois-verts-2e-regionale-europe-centrale-et-orientale>

Organizata e Ndërkombëtare e Frankofonisë numëron 88 shtete dhe qeveri anëtare: 54 anëtarë të plotë, 7 anëtarë të asociuar dhe 27 anëtarë vëzhgues.

Për më shumë : www.jeunesse.francophonie.org